



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:131830

Datë: 04.01.2023

Numri i dokumentit: 03843733

PKR.nr.98/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, me kryetarin e trupit gjykues Ilir Bytyqi dhe anëtarët e trupit gjykues Kreshnike Zymberi-Beqiri dhe Habib Zeqiri, me procesmbajtës Driton Ahmeti, bashkëpunëtorin profesional, në çështjen penale kundër të akuzuarit S.Z., nga Fsh. ..., K. Lipjan, për shkak të veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së, dhe veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 nën par.1.4 të KPRK-së, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.I.nr.96/19 të dt. 10.07.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik në praninë e përfaqësuesit të akuzës prokurorit Sebahate Sinani, të dëmtuarit R.A., të pandehurit S.Z. me av. mbrojtës Skender Musa dhe Leonora Dervishaj-Pacolli, me datë 09.12.2022 mori dhe publikisht komunikoi komunikoj, kurse me datën 04.01.2023 përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: S.Z. i lindur me ..., nga i ati A... dhe nëna V..., e gjinisë S..., me vendbanim në Fsh. ..., K. Lipjan, i pa martuar, punëtor fizik, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal, (në paraburgim nga data 19.06.2019 deri me 09.09.2019 dhe në arrestin shtëpiak nga data 10.09.2019 deri me 10.11.2019).

Ë S H T Ë F A J T O R

- Me datë 22.05.2019, rreth orës 08:35, në Shtime, saktësisht në parkingun e marketit “E.”, i pandehuri ka përdorur armën – një elektroskok, në atë mënyrë që i pandehuri së bashku

edhe me një person tjetër deri më tani të panjohur presin ne parking në momentin kur i dëmtuari R.A. dhe del nga vetura, i pandehuri e godet në gjokse me elektrohok, me ç' rast ky i fundit bie në tokë pa vetëdije, ndërkaq i pandehuri së bashku me personin e panjohur largohen menjëherë nga vendi i ngjarjes.

me këtë ka kryer veprën penale përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së.

- Në kohë dhe vendin e njëjtë, të përshkruar si në dispozitivin e parë të kësaj aktakuze, i pandehuri ka sulmuar fizikisht të dëmtuarin R.A., në atë mënyrë që në momentin kur ky i fundit del nga vetura, në atë moment i pandehuri me një mjet të përshtatshëm për shkaktimin e lëndimit trupor – elektrohok e godet një herë të dëmtuarin dhe atë në gjoks ku i njëjti bie në tokë dhe humb vetëdijen, ku si pasojë i shkakton lëndime trupore, të përshkruar si në raportin e ekspertizës mjeko ligjore të datës 25.06.2019.

me këtë ka kryer veprën lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 nën par.1.4 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të dispozitave të sipër cekura dhe neneve 2, 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 38, 39, 42, 69, 70, dhe 79 të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPR-së, e

Të pandehurit S.Z., i

CAKTON DËNIM

- Për pikën një të dispozitivit, vepra penale përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së, dënim me burg në kohëzgjatje prej pesë /5/ Muaj.
- Për pikën dy të dispozitivit, vepra penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 nën par.1.4 të KPRK-së, dënim me burg në kohëzgjatje prej dy /2/ Muaj.

**Gjykata, konform dispozitës ligjore të neni 76 par. 2 nen par. 2.2 të KPRK-se, të
pandehurin S.Z., e**

GJYKON ME DENIM UNIK ME BURG

- Në kohëzgjatje prej 6 /gjashtë/ Muaj, të cili dënim do ta vuaj menjëherë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.
- Konform nenit 57 të KPRK-se, i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 19.06.2019 deri me 09.09.2019 dhe në arrestin shtëpiak nga data 10.09.2019 deri me 10.11.2019.
- I dëmtuari R.A., me vendbanim në Rr.“...” pn. në Lipjan, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest civil.
- Obligohet i akuzuari që konform nenit 450 par.3 dhe 452 par.1 të KPPK-së, në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 50 Euro /pesedhjetë/, për shpenzimet e procedurës penale ekspertizë mjeko-ligjore shumën prej 20 Euro /njetzetë/, në afatin prej 30 ditëve pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.
- Obligohet i akuzuari që konform nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit, të paguajë shumën prej 50 / pesëdhjetë/ Euro, në afatin prej 30 ditëve pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Historiku i procedurës

Prokuroria Themelore në Ferizaj – Departamenti për Krime të Renda, ka sjellë për gjykim çështjen penale sipas akuzës PP.II.nr.96/19 të dt. 10.07.2019 në ngarkim të të pandehurin S.Z., nga Fsh. ..., K. Lipjan, për shkak të veprës penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së, dhe veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 nën par.1.4 të KPRK-së. Në shqyrtimin gjyqësor respektivisht në fjalën përfundimtare kam

betur pranë akuzës dhe kualifikimit juridik duke propozuar që të pandehurit ti shqiptoj një sanksion penal të paraparë me ligj.

Gjykata Themelore në Ferizaj – Departamenti për Krime te Renda, pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet të realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për të cilën është proceduar i pandehuri gjykohet nga trupi gjykues i departamentit për krime te renda dhe vendi ku është kryer ose tentohet të kryhet vepra penale.

Gjykata Themelore në Ferizaj – Departamenti për Krime te Renda, duke vepruar në këtë çështje penale mbajti shqyrtimet gjyqësor me dt. 07.12.2022 (shqyrtimi ka filluar rishtazi, konform nenit 331 par. 3 me aktvendim procedural janë konsideruar të lexuara deklaratat dhe provat pasi që kanë kaluar tre muaj nga shqyrtimi i fundit shkaku ndërrimit të trupit gjykues), në të cilën përfaqësuesi i akuzës-prokurori i shtetit, lexoj aktin akuzues dhe gjyqtari pasi që u bind se i pandehurit e ka kuptuar akuzën, konform nenit 325 par. 1 të KPPK-së, të pandehurit iu ofroj mundësinë të pranojnë fajësinë ose të deklarohej i pafajshëm.

I akuzuarit S.Z., në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë për veprën penale e cila iu vihet në barrë.

Mbrojtja e të akuzuarit

I akuzuari S.Z., që nga fillim të shqyrtimit gjyqësor nuk ka pranuar fajësinë për veprat penale sipas dispozitivave të aktakuzës, ndërsa në mbrojtjen e tij në shqyrtim gjyqësor të dt.07.12.2022, ka deklaruar se pas konsultimeve me avokatet e tij mbrojtës e shfrytëzon të drejtën ligjore që të mbrohet në heshtje.

Kurse në mbrojtjen e dhënë në hetuesi me dt. 21.06.2019, ka deklaruar se për ditën kritike me date 22.05.2019, ishte në Lipjan në vend punë në firmën “G.I.” si çdo dite nga ora 08:00 deri me 18:00, pas këtij orari është takuar me dajën e tij deri në ora 19:20, pjesën tjetër të ditës në shtëpi e në asnjë mënyrë të maketi “E.”. në Shtime nuk ka qene apo ta ketë lënduar te dëmtuarin R.A., këtë të fundit e njeh vetëm si biznesmen qe merret me ndërtim, nuk ka pasur

asnjë problem me të por nuk ka njohuri nëse edhe pronari (B.G.) ku punon i akuzuari te këtë ndonjë problem me R... Pra i pandehuri mohon te këtë kryer veprën penale për te cilën dyshohet kinse me arme elektroskok ta këtë goditur se me një person tjetër te dëmtuarin te “E.” ne Shtime.

Provat e paraqitura në shqyrtimin gjyqësor

Pasi që i akuzuari nuk ka pranuar fajësinë për veprën penale sipas kësaj akuze, Gjykata ka bërë paraqitjen e provave dhe pas vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht njëri me tjetrin, në kuptim të dispozitës së nenit 361 par. 1 dhe 2 të KPPK-ës, vërtetoj gjendjen faktike të përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimi:

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar përmes provave të prezantuara në shqyrtimin gjyqësor dhe atë:

- përmes leximit të akt ekspertimit mjeko-ligjor nr. ref. 01/2019, të datës 25.06.2019;
- përmes leximit dhe shikimit të video incizimeve të nxjerra nga kamerat e sigurisë CD- të;
- përmes leximit të raportit të oficerit 2019-AU-137 i datës 22.05.2019;
- përmes shikimit dhe leximit të fotografive të cilat gjenden në shkresat e lëndës;

Vlerësimi i provave të paraqitura në shqyrtimin gjyqësor

Fillimisht para se të i vlerësojmë dëshmitë e dëshmitarëve dhe provat tjera materiale është e nevojshme që të qartësohet se gjatë shqyrtimit gjyqësor janë vërtetuar në mënyrë të pakontestueshme faktet në vijim:

Me datë 22.05.2019, rreth orës 08:35, në Shtime, saktësisht në parkingun e marketit “E.”, i pandehuri ka përdorur armën – një elektroskok, në atë mënyrë që në momentin kur i dëmtuari R.A., ka dal nga vetura, i pandehuri e godet në gjokse me elektroskok te dëmtuarin, me ç ‘rast ky i fundit bie në tokë pa vetëdije;

Nga veprimet e te akuzuarit te dëmtuarit i shkakton lëndime trupore me pasoja te përkohshme për shëndetin, të përshkruar si në raportin e ekspertizës mjeko ligjore të datës 25.06.2019;

Se i akuzuari është identifikuar, kjo vërtetohet nga kamerat e sigurisë dhe nga dëshmitari F.K. dhe I.K.

Nga përmbajtja e të dëmtuarit në cilësi të dëshmitarit R.A., në shqyrtim gjyqësor është vërtetuar se me data 22.05.2019 ora 08:25 i dëmtuari kishte pirë një kafe, pastaj kishte shkuar te vendi i punës në Shtime në rrugën 14 dhjetori, me i vizitua punëtorët, sa po kishte arritur aty në parking tek një shtëpi e vjetër i kishte parë 2 persona duke qëndruar të cilët kishin qenë larg afërsisht 5 metra dhe madje po sa kishte zbritur nga automjeti i kishte futur qelsat e automjetit dhe telefonin në gjep, po sa ishte nisur për të dalur në rrugë e kishte ndjerë një goditje përnjëherë dhe ju ishin marruar mendtë dhe kishte rënë në tokë dhe disa sekonda kishte qenë pa vetëdije pastaj kishte ardhur I... dhe e kishte pyetur se çka ka ndodhur ai i kishte thënë se nuk e di ku pastaj të dëmtuarin e kishte dërguar te mjeku, dhe më vonë e kishte kuptuar kur i kishin shikuar video incizimin e "E." dhe një parking aty afër autolarjes, dhe punëtorët e tij i kishin se e ka goditur dikush. Ai kur kishte arritur atë ditë tek parkingu i kishte vërejtur dy persona ku e kishte parkuar automjetin dhe kishte dalur prej kerrit dhe po sa ishte larguar 3 metra nga vetura në rrugë ka qenë pjesa ku ata dy personat kishin qenë duke qëndruar tek muri, prej parkingut vendi ku kane qëndruar janë parë pasi që vetëm rruga i kishte ndarë, para se me ndodhur rasti i kishte parë punëtorët e tij që kanë qenë rreth 15 punëtorët aty ka qenë edhe I.. dhe F.. .

Dëshmitari ka prezantuar një dëshmi mjaft objektive dhe të saktë, për më tepër dëshmia e tij ishte e plotë dhe besueshmëria e saj rritet se paraqet fakte që ndërlidhen me provat materiale siç janë akt ekspertimit mjeko-ligjor nr. ref. 01/2019, të datës 25.06.2019, video incizimeve të nxjerra nga kamerat e sigurisë CD- të, raportit të oficerit 2019-AU-137 i datës 22.05.2019 dhe fotografitë të cilat gjenden në shkresat e lëndës, besueshmëria e kësaj dëshmie rritet edhe duke potencuar të gjitha faktet e prezantuara dhe me dëshminë e dëshmitarëve F.K., I.K., andaj gjykata i fali besimin e plotë dëshmisë së të dëmtuarit - dëshmitarit.

Nga përmbajtja e dëshmitarit F.K., është vërtetuar se para dy vite kishte punuar në Shtime mbrapa marketit E. në firmën "T." Sh.P.K ku pronar ishte I.K., i kujtohet se kishte qenë ora 07:25 aty i kishte parë dy persona e njëri prej tyre ishte S.Z., të cilin e kishte fqinjë, ndërsa tjetrin nuk e kishte njohur, rreth një orë më vonë në ora 08:25 i kishte vërejtur dy persona duke shkuar pas E.-it në parking, atëherë ai i kishte thënë pronarit (pune kryeit te ndertimit te vrazhd qe e kishte punesuar I.) që mos ke diqka në veturë pasi që ai e kishte të parkuar veturën aty, atëherë ai së bashku me pronarin e tij kishte shkuar në parkingun e E.-it dhe aty e kishin gjetur R.A., pa vetëdije i rrëzuar në tokë, ku të njëjtin e kishin marrë dhe e kishin dërguar te mjeku ne Emergjence. Dëshmitarit i kujtohet se i pandehuri S... ka pasur të veshur një jakne të zezë, dhe

ka pas të vendosur një kapel e thurrur a triko e cila është e ndarë nga jakna të cilën e ka pas të veshur edhe personi tjetër ka qenë i veshur njëjtë mirëpo ka qenë me shtatshkurtër. Ai e identifikon të pandehurin S..., ngase atë e ka fqinjë, jetojnë në të njëjtin fshat, kurse ai nuk është shoqëruar me të pasi që ishte gjeneratë më e vjetër se ai. Ai e ka parë të pandehurin në orën 07:25 pasi kishte kaluar aty pari ku e kishte parë S... duke pritur dhe largësia në mes dëshmitarit dhe të pandehurit ka qenë diku 10-15 metra, të cilët nuk e kanë përshëndetur njëri tjetrin. Kurse në momentet kur ka ndodhur rasti- kur e ka goditur R..., ai nuk e ka parë përveç se e ka parë të pandehurin dhe shokun e tij duke ikur dhe që të dy kanë ikur bashkë-paralel, aty nuk kishte dëgjuar asnjë krismë, asnjë fjalosje dhe asnjë thirrje përveç se kur kishte shkuar me I.. e kishin gjetur R.. të shtrirë në tokë.

Dëshmitari ka prezantuar një dëshmi mjaft objektive dhe të saktë, për më tepër dëshmia e tij ishte e plotë pasi që dëshmitari e bënë identifikimin e të pandehurit pasi që të njëjtin e ka edhe fqinjë dhe atë e kishte vërejtur ditën kritike se i pandehuri ka pasur të veshur një jakne të zezë, dhe ka pas të vendosur një kapel- e thurrur ao triko e cila është e ndarë nga jaknja të cilën e ka pas të veshur edhe personi tjetër ka qenë i veshur njëjte mirëpo ka qenë me shtatshkurtër dhe besueshmëria e saj rritet se paraqet fakte që ndërlidhen me provat materiale siç janë akt ekspertimit mjeko-ligjor nr. ref. 01/2019, të datës 25.06.2019, video incizimeve të nxjerra nga kamerat e sigurisë CD- të, raportit të oficerit 2019-AU-137 i datës 22.05.2019, dhe fotografitë të cilat gjenden në shkresat e lëndës, besueshmëria e kësaj dëshmie rritet edhe duke potencuar të gjitha faktet e prezantuara dhe me dëshminë e e të dëmtuarit - dëshmitarit R.A., dhe dëshmitarit I.K., andaj gjykata i fali besimin e plotë dëshmisë së dëshmitarit.

Nga përmbajtja e dëshmisë së dëshmitarit I.K., i cili ka deklaruar se është pronar i ndërmarrjes ndërtimore “T.C.” SH.P.K, i kujtohet se dita kur ka ndodhur rasti, dikund rreth orës 07:20-07:30, ka shkuar në Shtime pasi kam qenë duke punuar në objektin afaristo-banesor, ku inestirot është R.A., në momentin kur kishte dal nga vetuar për të shkuar tek objekti ku ishte duke punuar e që është një distancë prej 30 metra larg, aty i kishte vërejtur dy persona, nga vendi ku e kishte parkuar veturën distanca ka qenë diku 10 metra, ata dy persona kane qenë duke qëndruar në këmbë mbrapa një objekti njëkatësh për rreth rrugës, të cilët nuk i kishte njohur, ku njeri ishte me i gjatë e tjetri më i shkurtë, ai i cili ishte më i gjatë kishte te vendosur në kokë një kapel e cila ishte kapel e jaknes së tij, mirëpo se çfarë ngjyre ka qenë nuk i kujtohet. Kur kishte ardhur R.. me veture e tij Audi, i njëjti e ka parkuar veturën në të njëjti parking afër veturës sime,

ai nuk e kishte parë R.. duke u parkuar pasi që ato momente une ka qenë në një distancë prej 60-70 metra te objekti ku ishte duke punuar, dhe në ndërkohë punëtori i cili ka qenë duke punuar armaturën F.K., i kishte thënë “ngaj se ta thyunen kerrrin”, dhe kur kishte shkuar aty e kishte gjetur R.. të shtrirë në tokë, afër veturës së tij, dera e veturës se tij ka qenë e mbyllur dhe në ato momente e kishte pyetur se qka u bë ai i kishte thënë “nuk e di ndoshta tensioni diçka”, të cilit ia japin ndihmë dhe në ato momente e kishte vërejtur se e kishte kokën të lënduar pasi që kishte shenjë në kokë me siguri nga rrezuarja e tij, pasi që toka ka qenë e shtruar me gurë-zhavor dhe me veturën e të dëmtuarit-R.. e kishte dërguar në ambulancën e Shtimes, ku i është nënshtruar kontrollës mjekësore dhe i është dhënë ndihma e parë. Në ato momente gjersa ishin në ambulancë i dëmtuari – R... nuk i kishte treguar asgjë, por pasi kishte shkuar në shtëpi diku në kohë të drekës, e kishte thirrur në telefon dhe i kishte thënë “diçka nuk është në rregull, po dyshoj se më ka sulmuar dikush, ata personat të cilët janë kanë duke prit” kurse dëshmitari i kishte thënë se punëtorët por edhe një fëmijë 13 vjeçar i kishte thënë se ata dy personat e kanë rrahur R..-G.... Pastaj dëshmitari së bashku me të dëmtuarin kanë shkuar te pronari i parkingut dhe i kanë kërkuar kamerat e parkingut, ku aty në incizim shifet se ata dy personat të cilët kanë qenë duke pritur aty e kanë sulmuar të dëmtuarin, në incizim shifet se vetëm njeri prej tyre ai më i gjati e ka sulmuar R.. . Dëshmitari incizimin e ka parë personalisht dhe ata dy persona të cilët kanë qenë duke pritur ata i ka parë edhe në incizim, të cilët i ka identifikuar përmes gardërobës, gjatësisë dhe kapelës të cilën e ka pasur të vendosur në kokë, ku të njëjtit në dukjen e tyre janë parë edhe në kamerat të cilat i ka shikuar.

Dëshmitari ka prezantuar një dëshmi mjaft objektive dhe të saktë, për më tepër dëshmia e tij ishte e plotë dhe besueshmëria e saj rritet se paraqet fakte që ndërlidhen me provat materiale siç janë akt ekspertimit mjeko-ligjor nr. ref. 01/2019, të datës 25.06.2019, video incizimeve të nxjerra nga kamerat e sigurisë CD- të, raportit të oficerit 2019-AU-137 i datës 22.05.2019, dhe fotografitë të cilat gjenden në shkresat e lëndës, besueshmëria e kësaj dëshmie rritet edhe duke potencuar të gjitha faktet e prezantuara dhe me dëshminë e e të dëmtuarit - dëshmitarit R.A. dhe dëshmitarit F.K., andaj gjykata i fali besimin e plotë dëshmisë së dëshmitarit.

Nga përmbajtja e dëshmitarit S.G., të dhënë në shqyrtimin gjyqësor i cili ka deklaruar se të pandehurin e njehë në bazë të një shoku i cili i kishte sugjeru që S.Z. ta marrë si punëtor, para 7 viteve, raporetet me S.Z. i kemi pas te mira dhe vazhdojnë edhe sot, me date 22.05.2019 është taku me S.Z., në ora 08:00 te mëngjesit në kafiterin “I.” në Lipjan, dhe qëllimi i takimit

ishte sepse Komuna e Lipjanit i kishte dhënë një afat ta pastroj ambientin e vendpunishtes së objektit “G.I.” ku pronar ishte B.G., ku kishin pi nga një kafe pastaj kishin shkuar në vendpunishte ku kishin punuar deri ne ora 17:00, që i bie tërë ditën ka qëndruar me të pandehurin S.Z.

Nga përmbajtja e dëshmisë së dëshmitarit B.G., të dhënë në shqyrtimin gjyqësor i cili ka deklaruar se të pandehurin pas nxënës në shkollën fillore të fshatit ..., i cili ka punuar në objektet banesore që ai i ka ndërtua, kryesisht nga nënkontraktohet dhe kohë pas kohe ka punuar kryesisht në largimin e materialeve inerte, përfshirë edhe periudhën kohore të muajit maj të vitit 2019, pas këtij viti me S.. nuk ka pasur marrëdhënie kontraktuale me dëshmitarin apo kompaninë e tij, të dësmtuarin R.A.. e hjuh si fqinje dhe ka pas një bashkëpunim te imponuar per shkak të planit urban komunal, ai personalisht nuk kam pas asnjë mosmarrëveshje përpos asaj qe kam deklaruar ne prokurori kur ka ardhë një herë në zyrën time R..., gjatë kohës kur ka ardhe R... në zyre S.Z., nuk ka qenë punëtor i imi.

Dy dëshmitarët e sipër cekur S.G. dhe B.G., të cilët në mënyrë jo bindëse pasi që dëshmia e tyre janë në kundërshtim të plotë me provat e tjera materiale, pasi që dëshmitari S.G., deklaroi se ai fillimisht ishte takuar në ora 08:00 me të pandehurin dhe atë ditë kishte qëndruar tërë ditën në vendpunishte e që kjo deklaratë është në kundërshtim me deklaratat e të dëmtuarit dhe dëshmitareve F.K. dhe I.K. të cilët kanë deklaruar se të pandehurin e kishin hasur në Shtime së bashku me një person tjetër si dhe me provën materiale CD- videoncizimet e marra nga kamerat e sigurisë të cilat janë në shkresat e lëndës, andaj gjykata nuk ia fali besim dëshmisë së dëshmitarëve.

Nga prova materiale akt ekspertimi mjeko ligjor nr. 01/2019 të dt. 25.06.2019, në mendimin dhe konstatimin përfundimtar dëmtimet e të dëmtuari R.A., paraqesin: gjakderdhje nen lëkurore në regjionin zverkor të kokës, në anën e majtë të nofullës së gojës dhe në bark, me besueshmëri të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë mprehtës (jo i mprehtë, i topitur) dhe si të tilla një nga një dhe së bashku bëjnë pjesë dëmtime të lehta trupore dhe me dëmtim të përkohshëm të shëndetit.

Kurse përmes provave materiale (leximi i raportit të oficerit policor 2019-AU-137 i dt.22.05.2019 dhe shikimi e fotografive, gjykata vëren se me datë 22.05.2019 në ora 16:45 në stacion është paraqitur i dëmtuari R.A., për të paraqitur rastin se është sulmuar fizikisht nga dy persona në parkingut e E.-it derisa ishte duke zbritur nga vetura e tij në ora 08:34 kishte humbur ndjenjat dhe një punëtor i tij e kishte gjetur pa vetëdije e ishte ndihmuar të qohet dhe e kishte dërguar në Q.M.F Shtime ku ka edhe një raport mjekësor, kur ishte kthyer te vend punishtja e kishte kuptuar se është sulmuar nga dikush. Sipas disa kamerave të një autolarje ku pronar është N.S., shihet se dy persona e kanë goditur nga prapa derisa ishte duke zbritur nga vetura, që më vonë është plotësuar edhe me ekspertizën e mjeko ligjor dhe deklaratat e dëshmitarëve të sipërcekur.

Me leximin – shiqimin e provër materiale CD –të marrë nga kamerat e sigurisë gjykata ka vërejtë se në skajin e parkingut afër një objekti vërehen dy njerëz njëri më i gjatë me rroba të zeza, duke qëndruar, në ndërkohë afër tyre vjen një veturë Audi, ngjyrë e zezë, e cila parkohet në parking afër këtyre personave, shoferi i kësaj veture i dëmtuari dele nga vetura, mbyll derën e veturës dhe me tu larguar disa hapa nga vetura personat që ishin duke pritur aty afër i ofrohen shoferit të veturës (të dëmtuarit) dhe personi më i gjatë e sulmon fillimisht dhe nga aty largohen shumë shpejt, ndërsa shoferi (i dëmtuari) bie në tokë pa ndjenja.

Teoria e mbrojtjes së avokatit të të akuzuarit

Mbrojtja e të akuzuarit gjatë shqyrtimeve si dhe fjalës përfundimtare është sa i përket elementit subjektiv për dy veprat penale për të cilat ngarkohet i akuzuari im në asnjë fjali të vetme në aktakuzë nuk është përmendur se është kryer kjo veper me dashje apo formë tjetër të përgjegjësisë, pa element subjektiv të dashjes nuk ka vepër penale dhe gjithashtu pretendohet se ka pas edhe një person tjetër dhe nuk sqarohet edhe në diapozitiv kjo forme e përgjegjësisë dhe si e tillë aktakuza është e paligjshme sepse nuk mund të vërtetohet fajësia e asnjë të akuzuari pa u vërtetuar 4 elementet e veprës penale.

Fillimisht mbrojtësi i të akuzuarit ka potencuar se sa i përket elementit subjektiv për dy veprat penale për të cilat ngarkohet i akuzuari im në asnjë fjali të vetme në aktakuzë nuk është përmendur se është kryer kjo veper me dashje apo formë tjetër të përgjegjësisë, pa element subjektiv të dashjes nuk ka vepër penale dhe gjithashtu pretendohet se ka pas edhe një person tjetër dhe nuk sqarohet edhe në diapozitiv kjo forme e përgjegjësisë dhe si e tillë aktakuza është

e paligjshme sepse nuk mund të vërtetohet fajësia e asnjë të akuzuari pa u vërtetuar 4 elementet e veprës penale.

Sa i përket provave materiale që janë shqyrtuar në këtë proces gjyqësor ne nuk kontestojmë faktin se i dëmtuari ka mund të lëndohet dhe sulmohet nga një person tjetër por në mënyrë absolute të këtij procesi nuk është vërtetuar se i mbrojturi im ka qenë me date 22.05.2019 në Shtime në vendin ku pretendohet se është kryer vepra penale dhe se alibia e tij se këtë ditë ka qenë në vendin e tij të punës respektivisht në punishten e ndërtimit dhe ka pastruar gjithë ditën mbetjet inerte të betonit dhe që dëshmitari S.G., e ka vërtetuar me dëshminë e tij të dhënë para kësaj gjykate.

Gjithashtu alibinë se ditën kritike nuk ka qene fare ne vendin ku dyshohet të ketë ndodhë rasti edhe në mbrojtjen e paraqitur nga ana e të mbrojturit tonë në prokurorinë e shtetit, nga dëshmia e B.G. dhe S.G., por edhe në bazë të provave material rreth CD-ve e ne mënyrë të veqant momenti kur shihet vetura “Audi” dhe që vërtetohet me faktin se imbrojturi i tij në kohën kur ka ndodhë rasti nuk ka pas veturë dhe në anën tjetër prokuroria e shtetit dhe policia kanë dështuar që të verifikojnë dhe identifikojnë pronarin e shoferit e veturës me të cilin dyshohet që ka qenë të dyshuarit.

Në bazë të dispozitave të KPPK-së, është obligim i prokurorit të shtetit që ti kryej hetimet të bëjë individualizimin e personave dhe provave në mënyrë të saktë dhe në pajtim me nenin 7 par.1 dhe 2 të KPPK-së, të i shqyrtoj si prova lehtësuese dhe rënduese që në këtë rast në mënyrë absolute nuk është abatur kjo dispozitë. Sa i përket dëshmisë së pales së dëmtuar i njejt ka deklaruar vazhdimisht se nuk e ka pare të pandehurin që ta ketë goditur me elektrohok por të gjitha informacionet ka marrë nga dëshmitari F.K., i cili së bashku me dëshmitarin tjetër I.K., që të dy në kohën kur ka ndodhur rasti kanë qenë punëtorë të pales së dëmtuar.

Duke pasur parasysh kjo aktakuzë nuk ka bazë ligjore për shkak se nuk i plotëson elementet e veprave penale pasi që nuk ka prova se është sekuestruar elektrohokun dhe ky është supozim i prokurorit të shtetit se ka pas elektrohok sepse nuk ka pas asnjë prove material në këtë drejtim në munges të provave material trupi gjykues të zbatoj nenin 3 të KPPK-së mëdyshjet shkojnë në faver të akuzuarit. Andaj i propozon gjykatës që të pandehurin ta liron nga akuza.

Vlerësimi i teorisë së mbrojtjes

Duke vlerësuar pretendimet e mbrojtësit të të akuzuarit S.Z., av. Skender Musa, të paraqitur në fjalën përfundimtare, i cili ka pretenduar se nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprat penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së si dhe veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 nën par.1.4 të KPRK-së, si dhe propozimin për lirimin e tij nga akuzat, janë të pabazuar.

Por, gjykata vlerëson se nga administrimi i provave materiale si: akt ekspertimit mjeko-ligjor nr. ref. 01/2019, të datës 25.06.2019, video incizimeve të nxjerra nga kamerat e sigurisë CD- të, raportit të oficerit 2019-AU-137 i datës 22.05.2019, dhe fotografitë të cilat gjenden në shkresat e lëndës, përmes dëgjimit të dëmtuarit në cilësinë e dëshmitarit R.A., deklaratave të dëshmitarve F.K. dhe I.K., është provuar se i akuzuari S.Z., ka konsumuar elementet e veprave penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së si dhe veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 nën par.1.4 të KPRK-së.

Se mbrojtja është e pabazuar e vërteton nga deklaratat e të dëmtuarit R.A., dhe dëshmitarëve F.K. dhe I.K., vërtetohet se i pandehuri me datë të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi të pandehurin e kanë parë e duke qëndruar afër një objekti të vjetër te parkingu i E.-it duke pritur së bashku me një person tjetër e të cilët e përshkruajnë se qfar kishte përshkruar se i pandehuri ka pasur të veshur një jakne të zezë, dhe ka pas të vendosur një kapel e thurrur triko e cila është e ndarë nga jakna të cilën e ka pas të veshur edhe personi tjetër ka qenë i veshur njëjtë mirëpo ka qenë me shtatshkurtër, si dhe dëshmia e dëshmitarit F.K., e njëjtte edhe personalisht të pandehurin pasi që e kishte edhe fqinjë dhe në momentin kur ka ndodhur rasti nuk e kishte parë por i kishte vërejtur të pandehurin dhe personin tjetër paralel duke ikur nga vendi i ngjarjes, ndërsa kur kishte arritur te vetura e të dëmtuarit e kishte vërejtur të dëmtuarin në shtrirë në tokë të cilin së bashku me dëshmitarin I.K., e kishte dërguar në emergjencë në Shtime, e të gjitha këto vërtetohen edhe nga prova materiale CD-të të marra nga kamerat e sigurisë në të cilat vërteton të gjithë ngjarjen e ditës kritike si ka ndodhur.

Vlerësimi ligjor i veprimeve të akuzuarit

Gjykata vlerëson se në veprimet e të akuzuarit, janë plotësuar të gjitha elementet qenësore të figurës së veprave penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së si dhe veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 nën par.1.4 të KPRK-së, pra objekti i veprës penale në këtë rast janë marrëdhëniet juridike të mbrojtura me legjislacionin në fuqi, pasi që i pandehuri me veprimin e tij ka rrezikuar jeta dhe shëndetin e personave, vepra penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm dhe vepra penale lëndim i lehtë trupor janë konsumuar nga i pandehuri pasi që me përdorimin e armës – elektroshokit, në atë mënyrë që në momentin kur i dëmtuari del nga vetura, i pandehuri së bashku edhe me një person tjetër deri më tani të panjohur, të dëmtuarin e godasin në gjokse me elektroshok, me ç ‘rast ky i fundit bie në tokë pa vetëdije, ndërkaq i pandehuri së bashku edhe me të dyshuarin tjetër largohen menjëherë nga vendi i ngjarjes.

Ndërsa subjekti i kësaj vepre penale është i pandehuri S.Z., i cili këtë vepër e ka kryer me formë të dashjes pasi që në kundërshtim me ligjin për armët e ka përdorur armën elektroshokun me të cilin e sulmuar të dëmtuarin e të cilit i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore të cilat janë konstatuar në bazë të raporteve mjekësore dhe ekspertizës mjeko ligjore me nr.01/2019 të datës 25.06.2019.

Vlerësimi lidhur me dënimin e shqiptuar.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimin për të akuzuarin, Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të neni 73 dhe 74 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethana lehtësuese se i akuzuari nuk ka rënë ndesh me ligjin, këto rrethana i ndërlidhi edhe me moshën dhe sjelljen e tij korrekte gjatë procedurës penale, por megjithatë rrethanat e lartëcekura janë të natyrës personale krahasuar me rrethanat rënduese se me veprimet e tij (dashjes dhe motivi i ulët), i pandehuri ka përdorur armën – një elektroshok (e bënë fizikisht të paaftë në momentin e përdorimit ndaj viktimës), në atë mënyrë që në momentin kur i dëmtuari ka dal nga vetura, i pandehuri së bashku edhe me një person tjetër, të dëmtuarin e godet në gjokse me elektroshok, me ç ‘rast ky i fundit bie në tokë pa vetëdije, ku si pasojë i shkaktonte lëndime trupore, të përshkruar si në raportin e ekspertizës mjeko ligjore të datës 25.06.2019 si dhe shkallën e përgjegjësisë penale për të pandehurit dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Megjithatë, gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit është e bindur se me anë të këtij dënimeve është e pritshme të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 41 të KPRK-ës, dhe se me anë të këtyre dënimeve do të arrihet qëllimi i dënimit, parandalimi i kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe njëkohësisht do të arrihet edhe qëllimi tjetër që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Kërkesa pasurore juridik edhe shpenzimet procedurale

I dëmtuari R.A., me vendbanim në Rr.“...” pn. në Lipjan, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest civil.

Obligohet që konform nenit 450 dhe 452 të KPPK-së, i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj kësaj gjykate shumën prej 20 Euro /njëzetë/, për shpenzimet e procedurës penale ekspertizë mjeko-ligjore shumën prej 50Euro /pesëdhjetë/, në afat prej 15 ditëve nga dita plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcenim të ekzekutimit me dhunë.

Obligohet i akuzuari që konform nenit 39 par. 3 pika 3.1, të ligjit Nr. 05/L-036 për kompensimin e Viktimave të Krimit, të paguaj shumën prej 50€ /pesëdhjetë/, në afat prej 15 ditëve nga dita plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcenim të ekzekutimit me dhunë.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA

PKR.nr.98/19, të dt. 04.01.2023

Bashkëpunëtori profesional

Driton Ahmeti

Kryetari i trupit gjykues

Ilir BYTYQI

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.